# 7.7 RENDITJA E FUSHAVE DHE NËNFUSHAVE

Fushat janë gjithmonë të rregulluara sipas renditjes në rritje të shenjave të fushave. Renditjen e fushave në regjistrim mund ta ndryshoni vetëm nëse keni disa përsëritje të një fushe. Përbrenda fushës së caktuar mund të ndryshoni edhe renditjen e nënfushave.

***Procedura***

1. Klikoni fushën e veçantë, e cila është e përsëritshme, ose nënfushën.
2. Përgjidhni metodën **Redaktimi / Zhvendos lart**.

   Fusha apo nënfusha zhvendoset për një vend më lartë.
3. Përzgjidhni metodën **Redaktimi / Zhvendos poshtë**.

   Fusha apo nënfusha zhvendoset për një vend më poshtë.

***Mundësitë...***

Fushën apo nënfushën e kopjuar e zhvendosni për një vend më lartë ose më poshtë edhe duke klikuar ikonën  ose .